



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	200/23
Nr. i fq. / Br. st	-14-
Data: / Datum	15.09.2023
VUSHTRRI- VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e VIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 korrik
2023 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 11:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Agron Përçuku, Fakte Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Alban Bajrami.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i komunës), Drejtorët e drejtorive, Bekim Zabërgja, kryesues i Komisionit për Ndryshim - Plotësimin (Hartimin) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij, Haki Maloku nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendi Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na kanë ardhur edhe tri pikë shtesë për të cilat do të diskutojmë nëse do të kemi mundësi t'i shtojmë në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Draft - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive në Komunën e Vushtrrisë;
- Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ish-objekti i QKMF-së për nevojat e Spitalit në Vushtri.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – kërkoj nga kryesuesja që të na njoftojë para çdo mbledhje të KPF-së për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të kuvendit nga MAPL-ja, për mbledhjet paraprake.

Ai kërkoj informatë me shkrim për punën e konsulentëve (prej kur kanë filluar punën), se çfarë dobie ka përfituar komuna nga puna e tyre.

Po ashtu, me planin e punës së kuvendit, ka qenë e planifikuar në muajin prill <Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë>. Kjo informatë nuk na ka ardhur nga Drejtoria për Inspektim dhe nuk kemi ndonjë informacion pse s'po raportohet për një gjë të tillë.

Ai tha se nuk e kemi ende raportin për ndërmarrjet: "Përparimi" dhe "Uniteti" nga komisioni i aksionarëve.

Përçuku kërkoj sqarim se pse në dëgjimin buxhetor në fshatin Samadrexhë nuk mori pjesë askush nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa? Si kryesues i atij takimi po ju them se nuk dolëm mirë para qytetarëve, për shkak se nuk kishim njohuri lidhur me planifikimet e buxhetit.

Sot na ka ardhur një e-mail nga sekretaria e kuvendit për mospagesë të komisionit të këshillave të fshatrave. Si anëtar i komisionit kërkoj sqarim se pse po luhet me këto mënyra

të delegimit të kërkesave për pagesa. Pse nuk po shkohet në mënyrën siç është shkuar herën e parë, kur është bërë pagesa, por po shkohet në metoda të ndryshme? Në e-mail thuhet nuk keni të drejtë të paguani përmes pagave dhe mëditjeve, kurse vendimi i kuvendit, i cili është cilësuar si vendim i ligjshëm nga MAPL-ja ceket edhe përmes kategorisë së pagave dhe mëditjeve, por edhe nga kategoria e subvencioneve. Përderisa nuk bëhen pagesat e këtyre komisioneve, ku e kemi kryer një punë, unë si anëtar i KPF-së dhe si anëtar i atij komisioni, nuk do të votojë asnjë pikë derisa të kryhen këto pagesa.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – pajtohem me parafolësin dhe çfarë unë kërkoj është një raport i punës së ndërmarrjes “Përparimi”, sepse janë bërë gati dy vite të kësaj qeverisje dhe nuk kemi pranuar asnjë faqe raport të punës nga kjo ndërmarrje e themeluar nga ky kuvend. Ai kërkoi që deri në seancë të rregullt (në fund të këtij muaji) të na vjen raporti i punës së ndërmarrjes “Përparimi”, njëkohësisht të na vjen edhe një raport i numrit të të punësuarve, gjegjësisht listës së të punësuarve që nga janari 2022, por edhe nga janari 2023 ta shohim se si është gjendja.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – sqaroi se unë kërkoja raportin e aksionarëve të ndërmarrjeve “Përparimi” dhe “Uniteti”, jo raportin e kompanisë. Pra, kërkoj raport nga aksionarët, sepse është ky kuvend që i ka votuar. Nëse ata nuk i shohin serioze kërkesat tona për raportim (që kanë pasur të raportojnë qysh në muajt paraprak), atëherë kërkoj nga kuvendi që t’i shkarkojë dhe t’i caktojë disa aksionarë tjerë që janë më të përgjegjshëm.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – lidhur me ligjshmërinë e vendimeve, ajo sqaroi se i dini afatet ligjore si nga ana jonë për përgatitje të vendimeve, por edhe afatet e ministrive. MAPL vendimet që nuk janë në domenin e saj i përcjell tek ministrinë e linjës dhe në shumicën e rasteve vlerësimi i ligjshmërisë së tyre nuk na kthehet deri në komitet. Mirëpo, në momentin që neve na kthehet ligjshmëria, ato bëhet publike edhe në faqe të MAPL-së, por nëse e shihni të nevojshme mund t’ua dërgojmë në postën elektronike.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – lidhur me raportin e ndërmarrjes “Përparimi”, ai deklaroi se do ta keni në detaje edhe për buxhetin se sa ka pasur të hyra prej shërbimeve që i kemi dhënë, por edhe sa persona janë punësuar prej që e kemi marrë mandatin. Por, do ta keni edhe numrin e të punësuarve që i kemi gjetur. Pra, do ta keni një pasqyrë transparente për këtë ndërmarrje. Idrizi deklaroi se në seancën e ardhshme do ta keni informatën për punën dhe mënyrën e angazhimit të secilit konsulent të angazhuar nga komuna.

Lidhur me dëgjimet buxhetore, ai tha se edhe për fshatin Dumnice jam njoftuar nga kryetari i fshatit që nuk ka marrë pjesë askush as nga legjislativi e as nga ekzekutivi. Unë jam i gatshëm të marrë pjesë aty ku ta shihni të nevojshme, por nuk kam mundësi t’i mbulojë të gjitha takimet.

Lidhur me pagesat e komisioneve, unë dua përgjigje konkrete nga juristët në komunë. Nëse nuk ka mundësi të pagesës përmes kategorisë <paga dhe mëditje>, atëherë qysh e kemi marrë vendimin në kuvend, e sjellim prapë dhe e ndryshojmë, pra e gjejmë mënyrën e pagesës. Komisioni e ka kryer punën e vet qysh duhet, me shumë përkushtim dhe në mënyrë profesionale. Prandaj, vetëm ta gjejmë mënyrën ligjore të pagesës së komisionit, unë jam i gatshëm ta bëjë atë.

Lidhur me kërkesën për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ish-objekti i QKMF-së për nevojat e Spitalit në Vushtri, kjo ka qenë edhe një herë në KPF. Ideja ka qenë që të përfitojmë edhe ne si komunë, sepse kemi mungesë të pronave. Unë pata një takim me ministrin e shëndetësisë dhe biseduam për çështjen e pronave, e sidomos në Banjskë, ku do të bëhej një zonë e mirë industriale. Edhe ministri i shëndetësisë, por edhe ministri i bujqësisë më premtuan se do të bisedojnë me ministren e drejtësisë për këto prona që ne si komunë i kemi shpall zonë të interesit. Në pronën që gjendet ish-objekti i QKMF-së, neve si komunë na duhet dhe kemi nevojë, por spitali është

në shërbim, jo vetëm të qytetarëve të Vushtrisë, por edhe të qytetarëve të Kosovës, se po vijnë me kryer këtu operacione. Ministrit për këtë çështje i kërkova vetëm një kusht, që të bëhen investime. Ai më premtoi se edhe nëse Emiratet e Bashkuara Arabe nuk do të investojnë, atëherë do të bëhen investime nga ministria.

Prandaj, po kërkoj që ta procedoni për kuvend këtë kërkesë. Kurse, në kuvend do të vijnë përfaqësuesit e spitalit dhe do ta prezantojnë projektin në detaje se çka do të investohet.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – kryetari e ceku që me nxjerrë vendim për pagesat e komisioneve. Nuk kemi nevojë me nxjerrë vendim tjetër, sepse e kemi një vendim të ligjshëm nga MAPL-ja edhe nga Ministria e Financave, ku në pikën katër thuhet se mjetet financiare të caktuara do të merren nga kategoria e pagave dhe mëditjeve dhe nga kategoria e subvencioneve në zyrën e kryetarit. Nëse është i ligjshëm ky vendim, atëherë pse pse po sillemi rreth e rreth dhe nuk i çojmë në mënyrën qysh i kemi dërguar herën e parë. Po më duket e dyshimtë mënyra e procedimit të pagesave, sepse nuk po dërgohen në mënyrë zyrtare nga personeli edhe për këtë arsye është mospagesa. Ky është problemi, hezitimi i sekretarisë së kuvendit, problemi ka emër është Bastri Duraku, ky le të japë sqarime dhe mos na detyroni me u orientu tek organet tjera që s’kemi as ne dëshirë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në muajin maj e kemi votu Rregulloren për themelimin e komiteteve të tjera siç parashihe me LVL, ku disa komuna tjera i kanë të themeluara kohë më parë. Në qoftë se e ka kaluar ligjshmërinë nga MAPL-ja, të kisha ftuar si kryesuese me na ftuar për formulën e ndarjes dhe në seancën e ardhshme propozimet me i votu edhe me i angazhu anëtarët e kuvendit në këto komitete.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – deklaroi se nuk na është kthyer nga MAPL as e ligjshme as e paligjshme. Kemi vetëm një përgjigje se është bërë një ankesë prej një anëtari të kuvendit edhe janë duke e shqyrtuar. Në momentin që na kthehet nga ministria do ju njoftojmë dhe vazhdojmë procedurat, sepse të gjithë jemi të interesuar t’i kemi edhe këto komitete tjera. Ajo tha se edhe në komunat tjera janë pothuajse jofunksionale, për shkak të mospagesave, pasi që Ligji i Pagave për momentin e ka pamundësuar një gjë të tillë.

Bastri Duraku, nga sekretaria e kuvendit – lidhur me pagesën e këtij komisioni sqaroi se sekretaria e kuvendit e ka kryer punën e vet, ashtu siç e ka paraparë vendimi i kuvendit, i cili është i konfirmuar nga Ministria e Financave. Ai tha se anomalia ekziston tek Ministria e Financave për shkak se në njërën anë i vërteton vendimet si të ligjshme dhe në anën tjetër shkakton pengesa në zbatimin e atyre vendimeve. Dy herë radhazi është dërgu lista përmes listës së pagave për kompensimin e këtij komisioni, mirëpo në dy rastet përgjigjja prej tyre ka qenë negative. Shumë mirë e tha anëtari i KPF-së që ekziston një pikë e vendimit ku pagesa mund të bëhet edhe nga kategoria subvencione dhe transfere. Andaj, duhet të gjendet një modalitet për kompensimin e këtij komisioni për ato mbledhje që kanë kryer punën e tyre në kuadër të Drejtorisë së Financave.

Benjamin Shala, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike – lidhur me raportin për kompaninë “Uniteti”, ai tha se një herë është sjellë në KPF dhe kuvend nga menaxhmenti, por në bazë të ligjit u kërkua që raporti të vjen nga komisioni i aksionarëve. Prandaj, kur të përgatitet nga komisioni do ta procedojmë.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se pasi që kryesuesja nuk ka arritur ta rregulloj zërimin, atëherë po kërkoj nga kryetari i komunës që të ndërmer masa për këtë çështje. Në të kundërtën, do të propozoj bojkotimin e seancave të kuvendit, nëse nuk krijohen kushte për punë.

U kërkua raport nga komisioni i aksionarëve që i ka zgjedhur kuvendi, jo nga qeveria komunale për raportim në seancën e radhës. Ky ishte një propozim, kurse një propozim tjetër ishte që të përgatitet një raport me shkrim. Deri më tani nuk kemi pasur asnjë raportim nga komisioni i aksionarëve të kompanisë “Uniteti” dhe “Përparimi”. Prandaj,

presim një raportim në seancën e radhës edhe për gjendjen ekonomiko-financiare të kompanisë, por edhe raportin e auditimit.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – tha se sa i përket çështjes së zërimit, nuk është përgjegjësi e inja. Ajo që është përgjegjësi e inja e kam kryer edhe me takime zyrtare, por edhe me shkresa. Kurse, në asnjë mënyrë nuk kam marrë përgjigje. Ajo tha se po kërkon sot nga Drejtoria për Administratë edhe ajo e Prokurimit të na i sqarojnë deri në seancën e radhës krejt procedurat se qysh është devijuar projekti që na veç e kemi aprovuar në kuvend. Pse s'është realizu në Drejtorinë e Prokurimit? Çka mund të bëhet tutje për realizimin e këtij projekti, që është aprovuar në kuvend, e qeveria komunale nuk e ka realizuar.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – me keqardhje po e them kryesuese, se ti nuk po i di përgjegjësitë dhe kompetencat tua. Ne e kemi votuar buxhetin dhe në kodin buxhetor të kuvendit të komunës ke pasur mjete dhe është dashur vet me inicuar procedurën. Nuk mundesh me kamuflu dhe me kërku prej Drejtorisë së Prokurimit dhe të Administratës një përgjigje se pse ka dështuar aktiviteti i prokurimit, i cili ka qenë një vit e gjysmë herët procedura të prokurimit. Unë e kam përcjellë dhe e di pse ka dështuar në fund. Ai aktivitet ka dështuar në mungesë të mjeteve të planifikuara në buxhet, pasi që është kthyer prej organit shqyrtues të prokurimit, por ajo është etapë e mbyllur. Po flasim për një situatë që tre muaj dhe nuk ke qenë në gjendje të ndërmerr kurrfarë lëvizje me kriju kushte, që je e obliguar për një gjë të tillë. Kuvendi i komunës e ka kodin e vet buxhetor dhe ke pasur mundësi me i nis procedurat vet.

Hava Mlinaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë – tha se projekti për rregullimin e pajisjeve elektronike, duke përfshirë edhe zërimin, votimin elektronik etj, ka qenë i planifikuar në kuadër të Drejtorisë për Administratë në vlerë prej 55 mijë euro. Ne si drejtori e kemi inicuar projektin qysh në muajin gusht 2022 në Drejtorinë për Prokurim. Fituesi i projektit është shpallur në prokurim në fund të muajit dhjetor 2022. Pas kësaj, ka qenë një ankesë, e cila e ka vonuar procesin dhe përgjigjja nga OSHP-ja na është kthyer në mars 2023. Mjetet e këtij projekti kanë shkuar në suficit, kurse nga të hyrat e bartura nuk kemi mundur të ndajmë mjete financiare për shkak të obligimeve kontraktuale. Ne e kemi shikuar mundësinë e rregullimit të këtyre pajisjeve, por këto pajisje janë të stërvjetuara dhe nuk ka pjesë për rregullimin e tyre. Këto informata i kemi nga dy operatorë, të cilët kanë qenë për ta parë mundësinë e rregullimit të këtyre pajisjeve. Krejt çka na mbetet si mundësi është planifikimi i mjeteve për vitin e ardhshëm për blerjen e pajisjeve të reja.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – meqenëse ne e kemi një rregullore të punës të kuvendit komunal dhe organeve të tij, tek 11.1 <pjesëmarrja në mbledhjet e kuvendit> thuhet se sekretaria e kuvendit duhet të sigurojë kushtet të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit. Domethënë iniciimi për këto kushte të kuvendit duhet të rrjedhë nga sekretaria e kuvendit për planifikim. Edhe një çështje tjetër desha ta ngris, gjatë seancës së kaluar, kam kërkuar që të bëhet plotësim -ndryshimi i draft rregullores së kompanisë “Uniteti” për tarifat e mbeutave, të cilat ne i kemi aprovuar në atë seancë dhe kryetari ka sugjeruar që do të procedohet. Meqenëse nuk është ardhur në KPF vendimi për plotësim-ndryshim të asaj rregulloreje, unë po kërkoj që sa më shpejtë të silltet dhe të caktohet komisioni, si dhe të përpilohet komplet plotësim-ndryshimi i draft rregullores meqenëse nga ajo rregullore po dëmtohen qytetarët e më së shumti bizneset të cilët po operojnë në qytetin e Vushtrrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se me të vërtetë është për keqardhje aspekti i neglizhencave apo dështimeve që po ndodhin në Komunën e Vushtrrisë për sa i takon investimeve kapitale gjegjësisht realizimit të planifikimit të investimeve. Ne e kemi miratuar buxhetin në vitin 2022 që s'ka pasur paraprak edhe e kena propozu me u rregullu salla, votimi elektronik, mikrofonat, çështje teknike dhe kjo s'ka ndodhë. Tash po e

kuptojmë që s'po ndodhë as në vitin 2023, po vjen viti 2024 dhe po shkojmë në përfundim të mandatit. Meqenëse kanë dështuar këto krejt, e kam thënë edhe një herë po e përsëris prapë, shikoni mundësinë dhe planifikoni një sallë të re komplet më lehtë ta ndërtoni një të re prej fillimit, më të gjerë, me kushte më të mira, se me të vërtetë kjo nuk i plotëson kushtet. Sepse, po kemi mbledhje të ndryshme, komemorative, solemne, siç është rasti me Ditën e Çlirimit dhe i votojmë propozimet për ndarjen e titujve, kur ka raste që kanë dëshirë familjarë të marrin pjesë në sallë, por s'ka hapësirë. Po ashtu, këto tavolina nuk kanë hapësirë as për material të kuvendit.

Bastri Duraku, nga sekretaria e kuvendit – është e vërtetë që ai nen thotë ashtu në rregulloren e punës të kuvendit. Mirëpo, duhet ditur që sekretaria e kuvendit nuk ka kod buxhetor, nuk ka person të autorizuar financiar që merret me iniciimin e procedurave. Prandaj, duhet me i dallu këto çështje, sepse ne nuk mund të bëhemi instalues të mjeteve elektrike, se jemi juristë. Kemi bërë kërkesë me shkrim në Drejtorinë e Prokurimit që të merret me këtë çështje, si dhe e kemi thirrë një kompani që të merret me mikrofonta, por nuk kanë mundur ta rregullojnë.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se disa pika nuk janë proceduar në bazë të LVL-së dhe statutit të komunës. Sepse, nuk mundet asnjë drejtor apo drejtoreshë, apo staf i komunës me propozu pika të rendit të ditës për KPF dhe kuvend. Sot kemi disa pika që janë proceduar pa rekomandimin apo propozimin e kryetarit të komunës.

Ndërkaq, draft – rregullorja për punën e kuvendit është përpiluar në kundërshtim të plotë me vendimin e kuvendit komunal, sepse sipas vendimit që është formuar komisioni, në pikën shkruan për kompetencat dhe detyrat çka duhet të kryejnë ky komision. Komisioni ka pasur për detyrë të hartojë plotësim-ndryshimin e rregullores për punën e kuvendit. Kurse, propozimi që na është dërguar më shumë i përngjanë statutit se rregullores së punës së kuvendit. Ai tha se ka shumë gjetje aty, mirëpo pa dashur të lëshohet në gjetje, kjo nuk i plotëson kushtet ligjore për me rekomanduar për shqyrtim në kuvend, sepse është kundërshtim të plotë me vendimin e kuvendit, sepse për detyrë komisioni ka pasur me hartu ndryshimet dhe plotësimet e neneve të caktuara, por jo hartimin e plotë të rregullores së punës së kuvendit.

Ai propozoi anulimin e vendimit për formimin e komisionit që ka qenë në fuqi, sepse ky komision nuk ka ditur me hartuar një rregullore dhe të krijohet një komision tjetër.

Ndërkaq, të gjitha pikat që janë proceduar pa nënshkrim të kryetarit duhet të largohen nga rendi i ditës dhe mos të trajtohen fare.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – lidhur me mosnënshkrimin e materialeve tha se ka të drejtë Ilmiu në atë çka po e thekson, sepse materialet për KPF e kuvend duhet të nënshkruhen nga kryetari, por në këtë rast nuk e kisha adresuar fajin tek drejtorët, sepse është sekretaria e kuvendit filtri që e përgatit dokumentacionin. Drejtorët mund të jenë arkitektë, inxhinerë, ekonomistë dhe nuk i njohin procedurat. Prandaj, ju jeni ata që vendosni apo i largoni nga rendi i ditës apo po e nxjerrni një rekomandim që mos të vjen asnjë material pa iu nënshtruar rregullave dhe procedurave.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – po kërkoj edhe një herë nga Kryetari i komunës dhe prej drejtorëve të drejtorive që të respektohet afati ligjor për dorëzimin e materialit, pa dashur ta justifikojë këtë pjesën që e tha kryetari që pajtohem plotësisht. Po ju njoftojë edhe juve anëtarë të KPF-së, se drejtorët e drejtorive asnjëherë nuk i kanë dërguar materialet brenda afatit ligjor, pra nuk po e respektojnë Planin e Punës së Kuvendit. Po duhet t'ju dërgojmë edhe e-mail për t'ua rikujtuar, por prapë i vonojnë materialet. Unë pajtohem që të gjitha pikat e rendit të ditës që nuk i kanë ndjekur procedurat të largohen nga rendi i ditës. Prej sot e tutje, ato pika që vijnë me kohë do të trajtohen, ato që nuk vijnë me kohë nuk do të trajtohen, madje edhe nëse nuk kemi asnjë pikë të rendit të ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – theksoi se na duhet një dakordim nga aspekti human për kalimin e këtyre pikave të rendit të ditës, kurse në aspektin ligjor nuk kemi të drejtë. Prandaj, unë personalisht pajtohem që këto pika të rendit të ditës të hiqen nga rendi i ditës, ashtu siç propozoi edhe kryesuesja, sepse nëse trajtohen nuk prodhojnë efekt juridik.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se ka pasur raste që kemi proceduar për kuvend çështje pa material fare. Por, këtu kemi materiale, por për shkaqe teknike nuk janë nënshkruar nga kryetari dhe deri në seancën e kuvendit këto rregullohen. Nuk po shoh arsye të qëndrueshme që këto pika mos të procedohen për kuvend.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – po bëhen krahasime nga seancat tjera, por unë jam që mos të procedohen për kuvend materialet që nuk i kanë respektuar procedurat. Nëse ka vullnet të kalohen, ta nxjerrim një rekomandim ashtu siç tha kryetari për t'i proceduar, por jo në këtë mënyrë.

Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se edhe nëse nuk procedohet informata për këtë seancë, s'ka problem, sepse për seancën tjetër do e përmirësojmë. Arsyeja pse nuk e kam nënshkruar është se kam qenë në pushim.

Dardan Abazi, drejtor i Drejtorisë për Arsim – tha se shpreh keqardhje që nuk është nënshkruar nga ana e kryetarit, sepse ashtu qysh ma kanë sjell zyratë ligjor e kam nënshkruar dhe e kam proceduar tutje. Kështu që herave tjera do të kem kujdes në këtë drejtim. Po ashtu, ju njoftoj që na duhet ta bëjmë edhe një plotësim shtesë në këtë informatë për kuvend, për shkak se për suksesin e nxënësve shkollat kanë afat deri më datën 16 për përditësimin e të dhënave në sistemin “SMIA”, pastaj ne do ta bëjmë analizimin dhe raportimin e këtij sukse.

Melihate Basholli - Latifi, kryesues e KK-së dhe e KPF- së – tha se a pajtoheni që me një rekomandim t'i shqyrtojmë këto pika të rendit të ditës dhe për seancën e kuvendit të përmirësohen a po jeni për t'i larguar nga rendi i ditës?

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – pasi që isha propozues për t'i larguar nga rendi i ditës, unë jam që t'i shqyrtojmë këto pika të rendit të ditës me rekomandim që të përmirësohen për seancën e kuvendit. Ndërkaq, draft – rregullorja për punën e kuvendit, e cila është përpiluar në kundërshtim të plotë me vendimin e kuvendit komunal nuk ka nevojë me u procedu për kuvend, sepse del e kundërligjshme.

Bekim Zabërgja, kryesues i Komisionit për Ndryshim - Plotësimin (Hartimin) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij – deklaroi se nuk desha tani ta kërkoja fjalën derisa të miratohet rendi i ditës, por pasi që u ngrit ky shqetësim po i jap disa sqarime. E para, komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës së kuvendit i miratuar nga kuvendi i komunës e ka pasur për detyrë me plotësu apo me ndryshu rregulloren. Në momentin kur tridhjetë për qind e rregullores ndryshohet, aty nuk ka plotësim, por është ndryshim. Unë prita prej kolegut tim edhe prej të gjithë juve me përshëndet këtë punë të jashtëzakonshme, e jo të merren me inate politike, sepse inati dhe profesionalizmi janë dy gjëra të ndryshme. Nuk mundesh me u nxjerrë pse unë kam ba ankesë për draft rregulloren e juaj (që ki të drejtë edhe ti me bërë ankesë) e tash me thanë gjëra të paqena, këtu është në kundërshtim me ligjin është në kundërshtim me atë këtë. Plotësisht komisioni është në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullorja është bërë në harmoni të plotë me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe statutin e komunës që derivojnë nga ligji dhe statuti. Rregullorja është ndryshuar për shkak se mbi tridhjetë për qind, jo po gjashtëdhjetë për qind është ndryshuar rregullorja, sepse kemi pasur një rregullore të mëhallave, lagjeve, e cila as për së afërmi nuk e ka plotësuar punën e mbarëvajtjes së punimeve të kuvendit. Për pjesëmarrje në mbledhje, udhëheqje të seancave, kryesuesja e kuvendit, mbledhjet e kuvendit dhe çdo anëtar i kuvendit është dashur me marrë me vete

ligjin për vetëqeverisjen lokale, statutin, sepse nuk kanë qenë të përfshira në rregullore as tridhjetë përqind. Pra, për çka bëhet rregullorja e punës së kuvendit, me ia lehtësu punën kuvendit dhe me i përfshi të gjitha çështjeve të cilat në çdo mbledhje anëtarë të kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe kryetari preken nga ato çështje të caktuara. Jam i bindur dhe e përgëzoj komisionin që kemi bërë punën më të mirë të mundshme dhe unë ju garantoj dhe ju siguroj që rregulloren të cilën e kemi plotësuar, ndryshuar është model për të gjitha komunat e Kosovës.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – kryesuese unë në aspektin profesional e thashë që ka dallim vendimi i kuvendit, nëse kish me qenë detyrë me vendim me ju caktu komisionit hartimi i rregullores është në rregull. Mirëpo, edhe në preambulën fillestare, por edhe në pikën dy të vendimit thuhet: “Komisioni i cekur në pikën një të këtij vendimi do të bëjë plotësim - ndryshimin (hartimin) e draftit të kësaj rregullore dhe të njëjtën do ta procedojë në kuvend për aprovim”. Domethënë janë akte, norma juridike të cilat nuk kanë nevojë as me u komentuar e as me hezitu. Komisioni në bazë të këtij vendimi ka pasur autorizimin dhe detyrën që ato nene të cilat kanë menduar se nuk janë funksionale ose mi plotësu ose me i ndryshu ose me i shtuar. Pra, ka mundur me shtuar ndonjë nen të caktuar në mënyrë që me u bërë një rregullore sa më funksionale dhe me ju përshtat rrethanave të reja në statutin e komunës, ku aty është një nen, i cili thotë se brenda gjashtë muajve të gjitha organet e komunës obligohen të hartojnë rregullore të reja dhe t’i harmonizojnë me statutin dhe ligjet në fuqi. Unë absolut jam pro këtyre rregulloreve, mirëpo ka shkelje substanciale të vendimit, gjegjësisht është ndryshim komplet i asaj çka i është dhënë besimi këtij komisioni me ato që e kanë prezantuar në kuvend. Edhe nëse e votohet në kuvend, sigurt ka me dalë e paligjshme, nuk e kalon ligjshmërinë. Kështu që nuk kemi nevojë me shku në këso testime, sepse po shihet që është në pyetje një analfabetizëm i llojit të vet se mos me dallu çka është plotësim-ndryshimi dhe çka është hartimi i rregullores kur e keni pasë vendimin secili anëtar i komisionit është aq e pajustificueshme. Nuk po mund ta kuptoj se nuk u kanë veç Bekimi dhe se nuk ka nevojë ai me marrë përgjegjësinë, se atij më së paku i bjen përgjegjësia, sepse ai me një votë prezanton këtu, si parti minore. Përgjegjësia bie mbi kryesuesen e kuvendit, e cila ka qenë pjesë e komisionit, përgjegjësia bie mbi Mek Selacin që përfaqëson me nëntë anëtarë në kuvend, përgjegjësia bie mbi Leonoren që përfaqëson me njëmbëdhjetë anëtarë në kuvend. Prandaj, pesha e përgjegjësisë nuk është e barabartë, sepse Bekimi mundet me notu më lehtë se është vetëm dhe e bartë një përgjegjësi të një grushti të votave dhe është diçka tjetër. Po ti kryesuese a mundesh me na e sqaru se me çfarë kredibiliteti e zgjodhët kryesues dhe kënd e ka përfaqësu këtu, Bekim Zabërgja? Ky po mundohet me u imponu e me u bërë më shumë se njëmbëdhjetë deputetë të PDK-së e me pasur vlerë, por vlera nuk falet, nuk dhurohet ajo duhet me u zotu, duhet me pasë pronën edhe intelektuale edhe morale edhe njerëzore. Bekim, me çfarë morali kërkojshe me u bërë kryesues i komisionit me një votë? A s’po e din vendin ku e ka çka është në pyetje? Mos të keqkuptohemi, unë e kam shumë mik Bekimin, por secili duhet me e ditë ku e ka vendin.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – deklaroi se nuk po e di tash a po mbetet kjo pikë, apo nuk po mbetet. Në qoftë se mbetet, më duhet të them diçka se çka është gabim në këtë rregullore. Anëtar i komisionit hartues u thirr në vlerat më të larta intelektuale, profesionale, evropiane, tejetatlantike, më të mirën në histori të Komunës së Vushtrrisë. Unë e kam një pyetje konkrete, rregullorja e punës së kuvendit a mund të mbivendoset juridikisht mbi Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (LVL)? Përgjigja ime është jo. Ky ndoshta e ka ndryshe dhe nëse përgjigja është jo, si ka mundësi që në nenin 22, pika e shkarkimit të kryesueses së kuvendit të vendos diçka çka nuk parashihet me LVL. Në draft-rregullore thuhet se kërkesa për shkarkimin e kryesuesit të kuvendit të komunës duhet me u bërë nga 1/3 e nënshkrimeve, së paku dhjetë ditë më herët. Le të ma gjejë diku në LVL që shkruan

kështu, po i them që e keni mirë. Mirëpo LVL nuk parasheh një normativë të tillë për shkarkimin e kryesuesit/es. Shkarkimi i kryesuesit/es mund të bëhet në cilëndo seancë të rregullt, kur anëtarët e kuvendit me shumicë të thjeshtë kanë dakordancë dhe votojnë për shkarkimin e saj.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – më lejoni që të lexoj vendimin e kuvendit që është marrë në kuvend, hiç s'po e lexoj krejt: “Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshim - plotësimin (hartimin) e rregullores”, kështu që nuk ka diçka të jashtëligjshme në këtë çështje. Kjo pikë e rendit të ditës duhet me mbetur në rend të ditës. Vendimi qysh është nxjerrë në kuvendin e komunës është plotësim – ndryshim (hartimi) i rregullores. Nëse është marrë vendimi gabimisht në kuvend është diçka tjetër, por kjo draft – rregullore është hartuar në pajtim me vendimin e kuvendit.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – tha se meqenëse po flasim për rregulloren të cilën na e rregullon punën e kuvendit dhe komiteteve, ku një rregullore ekzistuese është bërë që nga viti 2013 me plot mangësi, duke fillu nga marrja e fjalës së anëtarëve, që ka mangësi ajo rregullore e vjetër e deri tek vendimet të cilat po na sjellin pasoja tek marrja e vendimeve, siç është rasti i propozimit që ishte për planifikim të rregullimit të këtyre mikrofonave që u cek, sekretaria e kuvendit. Rregullorja e vjetër ka shumë mangësi. Kështu që unë e falënderoj komisionin në këtë komitet, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer. Po kalojnë tash në një anomali këtu dhe po kërkojmë shkarkimin e komisionit, kur dihet se personat të cilët po bëjnë kërkesë për anulim të vendimit të komisionit, janë ata të cilët kanë qenë vetë në komision dhe na kanë sjellë në kuvend një rregullore të kopjuar nga qytete të tjera. Pavarësisht asaj, ne është dashur me ju jep vërejtje, propozime dhe e kemi kaluar. Ndërsa sot, e shkoqisim një draft- rregullore që është ardhë këtu në mënyrën më të mirë (për mendimin tim të përpiluar), atëherë po hasim në vështirësi të shumta si KPF që jemi.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se është shumë rast i ndjeshëm (sidomos pozicionimi juaj si kryesuese) kur thoni që është në rregull vendimi. Prej pozitës së kryesueses përgjegjësinë e ke më të madhe sesa ne që jemi ulur këtu. Kështu që unë po të siguroj që absolut nuk është në përputhje me ligjin, hartimi i rregullores, sepse në bazë të vendimit keni pasur mandat me ba plotësim-ndryshimin e rregullores komunale. Mirëpo, nëse ju edhe më tutje insistoni që është në rregull, lirisht qite në votim, por edhe në kuvend nëse kalon, në ministri ju kthehet prapë. Jemi lodhur duke na u kthyer këto vendime të kundërligjshme.

Bekim Zabërgja, kryesues i Komisionit për Ndryshim - Plotësimin (Hartimin) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij – koleg i nderuar është hera e dytë apo e tretë që më drejtolesh si parti minore. Të gjithë anëtarët në këtë kuvend janë të barabartë me të drejtat e plota. E di, por po detyrohem të ta them se sasia dhe cilësia janë dy gjëra të ndryshme, kualiteti dhe kuantiteti ndryshojnë njëra me tjetrën.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, një (1) “kundër” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.6.2023;
2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Kuvendit;
3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale;
4. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar, Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore, Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve;

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës janar – qershor 2023;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit;
8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022/2023.
9. Shqyrtimi i Draft - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive në Komunën e Vushtrrisë;
10. Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ish-objekti i QKMF-së për nevojat e Spitalit në Vushtri;
11. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16.6.2023.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 16.6.2023.

2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Kuvendit.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – po e ripotencoj prapë se nenin 22, pika e shkarkimit të kryesueses së kuvendit, jo që kemi ndonjë iniciativë, por është bërë gabimisht fillimisht në statut të komunës, e masandej keni bërë gabim edhe në rregullore të punës të kuvendit. Unë po ju propozoj me e ndërru këtë nen e të bëhet siç e parasheh LVL-ja, në të kundërtën këtë rregullore kot e votojmë në kuvend, sepse edhe nëse ministria nuk do ta trajtojë ligjshmërinë, unë vetë kam me ankimuar, sepse është në kundërshtim me LVL.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – ju edhe mundeni me pasë ndonjë iniciativë për shkarkim, hiç nuk ka ndonjë problem, por prapë punën e vazhdojmë. Nuk mundemi me dalë jashtë statutit, sepse ky nen është i bazuar në statut.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – theksoi se statuti, rregullorja e punës, udhëzimet administrative edhe aktet e veçanta, të gjitha janë me fuqi më të ultë sesa Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe të gjitha duhet me qenë në pajtueshmëri me ligjin, që është kupola e rregullimit të çështjeve në nivelin lokal. Kështu që, statuti ka kalu qysh ka kalu, sepse po e shohim që MAPL-ja nganjëherë po priton me i trajtu, vetëm kur po adresojnë ankesa kuvendarët. Mirëpo, unë po ju tregoj se në qoftë se kjo rregullore e punës votohet në këtë formë, unë do ta apelojë, për shkak se neni 22 është në shpërputhje flagrante me LVL.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se draft-rregullorja e propozuar është në kundërshtim të plotë me vendimin e kuvendit të komunës dhe si i tillë nuk është dashur të futet në rend të ditës. Mund të futet në rend të ditës e me u diskutu, por nuk është mirë me u procedu për kuvend, sepse nuk prodhon kurrfarë efekti, për shkak se ka me dalë që nuk është e ligjshme. Gjetje brenda ka shumë, por ato do t'i shpërfaqim në seancën e kuvendit. Sa i përket nenit 22, nuk ka nuk ka kurrfarë devijimesh, për arsye se është i bazuar në statutin e komunës. Statuti i komunës i ka kaluar të gjitha fazat në MAPL, është në fuqi dhe prodhon efekte juridike. Këtu unë mendoj që kanë vepru mirë, por kanë vepru keq që nuk kanë bërë plotësim-ndryshim, por kanë hartu rregullore.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, e kisha sugjeruar kryesuesen që të konsultohet me zyrtarët ligjorë deri në seancë dhe të procedohet për kuvend dhe atje mund edhe ta heqim nga rendi i ditës dhe të propozohet që të anulohet vendimi për formimin e komisionit e

krahas saj edhe kthimi i shpenzimeve që janë krijuar nga ana e komisionit për punën që nuk e ka kryer.

Bekim Zabërgja, kryesues i Komisionit për Ndryshim - Plotësimin (Hartimin) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij – sa i përket nenit 22 që e ngriti si shqetësim Sylja, ai është në harmoni të plotë me statutin. Statuti është aprovuar me dy të tretat e anëtarëve të kuvendit dhe nëse bjen ky nen do të ndërrohej krejt statuti. Është e drejtë e secilit me bërë ankesë, por kjo çështje vjen në kuvend dhe atje mund të ipen propozime, plotësime, ndryshime dhe pastaj votohet. Si komision ne i kemi paraparë disa gjëra me i konsultu në koordinim me kuvendin, që bëhet fjalë për shmangien e rregullores (nëse jeni dakord me e fut). Shmangia nuk është futur, por si komision kemi diskutuar për këtë çështje.

Haki Maloku, nga zyra e kryetarit – tha se ka disa sugjerime rreth përmbajtjes së rregullores. Vetë rregullorja e ka titullin <Rregullore për punë të kuvendit>, ndërsa që në nenin e parë, paragrafi 1, thuhet: “Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, komiteteve obligative, konsultative, komisioneve dhe grupeve punuese të formuara nga kuvendi për ushtrim të kompetenceve dhe përgjegjësi të Kuvendit”. Pra, nuk është në përputhshmëri rregullorja me vetë përmbajtjen. Po ashtu, në disa nene tjera bëhet fjalë për Komitetin për Politikë dhe Financa e komitetet tjera, flitet edhe për kryetarin e komunës, teksti i betimit të kryetarit të komunës. Kjo do të thotë që kanë hyrë aq shumë nene që janë marrë nga statuti dhe janë kopjuar që nuk ka qenë e nevojshme. Në kuvend është aprovuar një rregullore për komitete dhe komisione dhe se në dy këto rregullore janë përfshirë mënyra e funksionimit të komiteteve. Çdokund ku figuron komitet dhe komision në këtë draft-rregullore është dashur të hiqet, për arsye se ekziston rregullore e veçantë për komitete dhe komisione. Këtë shqetësim e ngrita edhe më herët me Bekimin, por ai më tha që ajo rregullore për komitete nuk është ende në fuqi. Por, çka në qoftë se konfirmohet ligjshmëria në MAPL për të dyja rregulloret dhe kjo i bie që i kemi të përfshira çështjet e njëjta në dy rregulloret.

Lidhur me nenin 22, paragrafi 5 thotë që: “Të gjitha procedurat tjera për shkarkim rregullohen me Rregulloren e punës të Kuvendit”, a vet kjo është rregullorja e punës. Prandaj, në detaje është dashur në këtë draft – rregullore të përshkruhet procedura e shkarkimit të kryesuesit/es. Prandaj, ka shumë vend për korrigjim të këtij drafti. Unë s’kam të drejtë të propozoj se nuk jam anëtar i komitetit, por po sugjeroj që mos të procedohet në këtë mënyrë për kuvend ky draft, derisa të kthehet përgjigja nga MAPL-ja lidhur me rregulloren e komiteteve. Po ashtu, është një tekst i ngarkuar me nene të panevojshme që janë të parapara me ligj e statut. Prandaj, çështjet që janë të përfshira në statut, nuk ka nevojë të përfshihen edhe në rregullore. Sasia nuk e përcakton cilësinë dhe mos të mendohet që rregullorja e mëparshme ka pasur pak nene dhe ka qenë e pavlefshme. Prandaj, po sugjeroj që mos të procedohet në këtë mënyrë për kuvend ky draft, ose nëse procedohet të bëhen korrigjime.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – dua të ndërlihem te neni 5 i kësaj draft – rregulloreje, ku paragrafi 2 thotë: “Mandati i çdo anëtari/es të Kuvendit të Komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtar”, ndoshta kishte qenë mirë me ndryshu, që mandati me u verifiku nga sekretaria e kuvendit se nuk mundesh me ba komision pa u konsolidu kuvendi. Po ashtu, kryesuese ti si gjuhëtare me ndërhy ku ceket <pushon mandati>, me ndryshu dhe me plotësu me fjalë tjetër.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – meqenëse ishte propozimi për shmangie të rregullores nga anëtarët e komisionit, unë kisha thënë se kjo ka rrjedhë nga një seancë e kaluar, e cila ka pasur propozime për me ju shmang rregullores për një vendim për ndarjen e mirënjohjeve nga ana e kryetarit. Nëse shmangia e rregullores është në kundërshtim me

ligjin, mos të futet hiç ky propozim. Nëse kryetari dëshiron të jap më shumë mirënjohje, atëherë le të shkel kryetari rregulloren, e jo ne si anëtarë të kuvendit. Prandaj, shmangia e rregullores mos të futet.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – kam një pyetje konkrete për Hakiun: në bazë të përvojës suaj (që është zotim profesional i juaji), vendimi që e kemi marrë në kuvendin komunal për formimin e komisionit për plotësim – ndryshimin (hartimin) e rregullores: Komisioni a është dashur të hartojë rregullore komplet? Përkundër vendimit që i ka përcaktu detyrat që të kryej plotësim-ndryshimin e rregullores.

Haki Maloku, nga zyra e kryetarit – deklaroi se komisioni ka pasur mandat me hartu draft-rregulloren për ndryshim-plotësimin e rregullores, por jo tekstin e përgjithshëm. Fjala hartim në kllapa, nënkupton hartimin e ndryshim-plotësimeve, por jo krejt rregullores. Nëse komisioni gjatë punës kur ka filluar ndryshim-plotësimin, e ka vërejtur se ka nevojë shumë nene me u ndryshu, atëherë është dashur ta bëjë një raport dhe në kuvend me thënë që nuk mjafton vetëm ndryshim – plotësim i draft-rregullores, sepse ka kaq shumë ndryshime dhe ka nevojë për me ndryshu nene, por është e nevojshme me bërë tekstin e spastruar. Pastaj, kuvendi me i jep mandatin atij komisioni me e hartu draft-rregulloren e re. Por, jo komisioni ose një anëtar i komisionit me deklaruar me përqindje se sa nene është dashur me u ndryshu. Sipas meje, kjo procedurë është dashur të ndiqet.

Bekim Zabërgja, kryesues i Komisionit për Ndryshim - Plotësimin (Hartimin) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij – vetë fjala komisioni për ndryshim-plotësim (hartim) s'ka nevojë më tepër me zgjatë, sepse t'i jep të gjitha mundësitë, varësisht si e sheh.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se neni 22 i kësaj draft-rregullore bie në kundërshtim me nenin 47 të LVL, i cili flet për rendin e ditës: Neni 47.2 “Anëtar i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike. Neni 47.3 “Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës”. Këto dy nene duhet të parashihen tek shkarkimi i kryesuesit/es, sepse kështu si është në draft-rregullore është në kundërshtim me ligjin.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me gjashtë (6) vota “për”, një (1) “kundër” rekomandoi që me përmirësime, propozime të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – deklaroi se komisioni nuk është konsultuar fare me qeverinë komunale dhe me politikat të cilat qeveria komunale mendon ti zbatojë. Kemi propozime të cilat janë shumë të devijuara nga rregullorja paraprake, ku kanë shkuar në bazën e zgjerimit të klientelës, me pretendime për rritjen e të hyrave vetanake, që në raste të caktuar është shumë e arsyeshme. Mirëpo, ato raste determinohen, kur qeveria komunale ka investime kapitale jashtëzakonisht të mëdha dhe i mungojnë të hyrat vetanake. Atëherë, pikërisht funksioni dhe roli i kësaj rregullore që mbetet në domenin e kuvendit të komunës e ka këtë peshë, nëse kemi bërë investime të mëdha dhe na mungojnë mjetet vetanake, mund të vijmë në situata kur edhe atë koeficientin e arritshmërisë nuk mund ta ketë komuna. Prandaj, duhet të gjenden mekanizma rregullues për t'i balancuar të hyrat vetanake me investimet, por edhe me të hyrat e përgjithshme. Në rastin konkret, kjo draft-rregullore fatkeqësisht nuk e ka një parametër të tillë, të paktën në bazë të propozimeve që janë divergjente dhe janë të paarsyeshme skajshmërisht njëra me tjetrën. Aktualisht, ndodhemi para një akti që ka nevojë me ndërhyrë shumë në këtë draft, nëse dëshirojmë ta

kemi një rregullore edhe funksionale, por edhe në shërbim me interes të përgjithshëm. Me rregulloren paraprake është determinuar një çmimore e arsyeshme e shërbimeve që ofron komuna për qytetarët, sepse e edhe ligji e thotë ashtu që kostoja e shërbimit ndaj klientelës llogaritet në bazë të çmimit bazë të ofrimit të një shërbimi. Prandaj, çmimi duhet të jetë i kalkulueshëm se çka komuna shpenzon për ofrimin e një shërbimi për qytetarët. Në këtë draft, ka propozime për t'u kthyer taksa në firmë për bizneset. Azemi tha se komisionet e themeluara nuk po merren me analizë të çështjeve të caktuara. Ky draft më tepër është një kopje e ndonjë komune dhe nuk është kompatible për qytetin tonë.

Ai propozoi që taksa në firmë duhet të hiqet dhe të riformulohet me tekstin e ri ashtu siç ka qenë në rregulloren paraprake (ku kanë qenë vetëm institucionet financiare dhe lojërat e fatit).

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – theksoi se disa prej shërbimeve që kanë ndryshuar nga rregullorja paraprake janë shërbimet që kryen Drejtoria për Administratë. Disa tarifa janë rritur, e disa janë zvogëluar. Dëshmia e vdekjes ka qenë 1 euro, është propozuar që të jetë 5 euro. Të bëhet zero euro ose të mbetet 1 euro, siç ka qenë. Pastaj, vendosja e reklamave elektronike, ka qenë 150 euro, drejtoria ka propozuar 100 euro, kurse propozimi i komisionit është 150 euro.

Leje për bllokim të rrugës-shiritit rrugor-trotuarit për 24 orë, ka qenë 25 euro, propozimi i komisionit është 50 euro, po më duket shtrenjtë.

Ai tha se deri në seancë do t'i analizojmë edhe tarifat tjera.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – desha të ndalem tek çështjet që janë në kuadër të drejtorisë, gjegjësisht tek taksat dhe ngarkesat. Hartuesit e këtij drafti si duket nuk e kanë pasur të qartë se çka do të thotë SHPK. Ai tha se ka qenë rekomandim i organizatës USAID para disa viteve që të ndryshohet draft-rregullorja, sepse kjo ngarkesë për bizneset është e tepërt. Më herët është bërë regjistrimi i bizneseve në komunë dhe për atë shërbim është vendosur një taksë. Aktualisht bizneset regjistrohen në mënyrë elektronike, kurse për atë regjistrim po ngarkohen me taksë. Në vend që të stimulohen bizneset dhe të lirohen nga taksat dhe tatimet, në mënyrë që të gjenerojnë vende pune, si shume vende tjera, ne po i ngarkojmë me taksë.

Ai propozoi që taksa për bizneset të hiqet, sepse nuk ka nevojë të ngarkohen me taksë, sepse në mënyrë elektronike bëhet regjistrimi i bizneseve në ARBK.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri me rekomandime vendosi që ta procedojë për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se kemi të bëjmë me dështim skandaloz të realizimit të buxhetit, ku në krahasim me vitin e kaluar (për të njëjtën periudhë) kemi shpenzim të buxhetit për 100 mijë euro më pak në kategorinë e investimeve kapitale. Këtu mund të jenë disa situata: ose hartuesit e projekteve (kërkesave dhe specifikave) po i vonojnë ato, ose Drejtoria e Prokurimit nuk po i shpall me kohë, ose punët nuk po kryhen në terren, ose pagesat dhe pranimet teknike për kryerjen e punëve nuk po kryhen me kohë, ose dikush është duke sabotuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar, Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore, Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – pavarësisht se e kemi ngritur si çështje në kuvend, nuk ka ardhur për t'u votuar plani vjetori i ndarjes së subvencioneve, ashtu qysh parashihet me rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017, ku në bazë të kësaj është hartuar edhe rregullorja për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Vushtrrisë. Prandaj, auditori paska dhënë vërejtje në këtë pikë. Gjithsej kanë qenë 21 rekomandime që i ka dhënë auditori për vitin paraprak, ku 15 prej tyre nuk janë zbatuar e as inicuar fare, një rekomandim është pjesërisht i zbatuar, kurse 5 prej tyre janë të zbatuara.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – pjesa e parë janë komentet që i ka dhënë komuna dhe nuk ka pasur nevojë të përfshihen në raport, por është dashur të na vjen vetëm raporti i auditorit.

Medina Bunjaku, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport– Fatmirja e përmendi një raport që nuk është përpiluar, por ne si drejtori e kemi hartuar dhe e kemi dorëzuar në muajin janar në kryeministri, por nuk është përgatitur nga Drejtoria për Buxhet , e Bujqësisë dhe Shëndetësisë. Faktikisht është dashur të shkojë si pako, por e kanë dërguar vetëm të drejtorisë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se Rregullorja e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 thotë që: “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”, prandaj është dashur që ta votojmë edhe në kuvend dhe ndoshta ka pasur nevojë që të ipen rekomandime për rritjen e buxhetit në ndonjë kategori. Sa kam qenë unë në drejtori, në janar ose shkurt e kemi sjellë planin dhe aty janë ndarë vijat buxhetore për ndarjen e subvencioneve, kategorinë e librave, teatrit, rininë, kulturën dhe sportin.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës janar – qershor 2023.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022/2023.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Shqyrtimi i Draft - Rregullores për Kategorizimin e Klubeve Sportive në Komunën e Vushtrrisë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – propozoi që paragrafi 1.3 i nenit 4 të zhvendoset pas paragrafit 1.4. Ajo po ashtu kërkoi që të përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e sportistët e vitit. Kjo është një çështje që kemi pasur sfidë çdo vit, ku në disa raste ka pasur edhe përleshje fizike në mes të sportistëve (zyrtarët) që kanë qenë në komision.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – tha se është një rregullore e mirëseardhur, por fatkeqësisht që ka dështuar konsultimi publik dhe nuk kanë marrë pjesë palët e interesit që i prek kjo rregullore. Kjo çështje po na përcjell në të gjitha sferat. Ai tha se te tabela poentuese për kategorizimin e klubeve sportive, tek pika 2 < Tradita e klubit> kemi një diskrepancë të poentimit. Prandaj, të rishikohet ky poentim.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – Tek kriteri 9 <Ngritja e kapaciteteve>, pika 3 <mjekë sportivë>, sigurisht është menduar titulli specialistik dhe në Kosovë nuk ka. Propozoi që të ndërrohet emërtimi dhe të mbetet mjek i klubit.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

10. Shqyrtimi i kërkesës së Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ish-objekti i QKMF-së për nevojat e Spitalit në Vushtri.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

11. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **13:20**.

Bujar Klinaku



Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi



Kryesuese e KK-së dhe KPF- së